



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:035548

Datë: 23.06.2021

Numri i dokumentit: 01916753

P.nr.145/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit E. K. nga Gjilani për shkak të veprës penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.nr.272/2021 të datës 24.02.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 09.06.2021 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 23.06.2021 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri E. K. nga babai R. dhe nëna S., e lindur B., i lindur 04.04.1981 në Gjilan, ku edhe jeton rruga: “.....” numër 138, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i dy fëmijëve, i punësuar si metal punues, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 09.02.2021, rreth orës 12:50 minuta, në rrugën ‘Abdullah Presheva’ në Gjilan afër shtëpisë së të pandehurit E. K. deri sa i dëmtuari I. M. së bashku me shokun e tij A. I. ishin duke kaluar rrugës në pronë publike, të njëjtit sulmohen nga qeni i llojit pitbull, pronë e E. K. i cili e kafshon të dëmtuarin në këmbën e majtë të tij, me ç’rast të njëjtit i shkakton lëndime të lehta trupore dhe i cili për shkak të lëndimeve të pësuar detyrohet të kërkojë ndihmë në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan.

-Me çka ka kryer veprën penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së,

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,38,39,40,43,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 248 e 365 të KPP-ës të pandehurin e lartcekur :

E GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej 500 € (pesëqind euro), të cilën obligohet ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

I dëmtuari I. M. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

ARSYETIM

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 24.02.2021 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.272/2021 kundër të pandehurit E. K. nga Gjilani për shkak të veprës penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Me datë 09.06.2021 pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit dhe i pandehuri E. K. me mbrojtësin e tij me autorizim avokatin Masar Morina. Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i pandehuri i lartcekur kishte deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë, me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata në seancën shqyrtimit fillestar pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, se i pandehuri nuk ka qenë i

detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2021-CA-0159 i datës 09.02.2021, deklaratat e të pandehurit të dhëna në statet e mëhershme të procedurës penale, deklaratat e të dëmtuarit në statet e mëhershme të procedurës penale, deklaratat e dëshmitarëve A. I. dhe V. K. të dhëna në statet e mëhershme të procedurës penale, raportet e oficerëve, informacionet e të pandehurit, raporti mjekësor me numër 2605 të datës 09.2.2021 në emër të dëmtuarit I. M., ekspertiza mjeko ligjore e datës 22.02.2021 në emër të dëmtuarit I. M., foto dokumentacioni si dhe shkresat e tjera të lëndës po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: i pandehuri E. K. ka kryer veprën shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës ashtu që gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit, intensitetin e rrezikimit dhe dëmtimit të vlerës së mbrojtur, pranimin e fajit nga ana e të pandehurit si dhe rrethanat personale të kryesit.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh edhe rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës ashtu që si rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjykata mori faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, faktin se i njëjti ka kërkuar falje për këto veprime dhe njëkohësisht në çdo fazë i ka kërkuar falje edhe të dëmtuarit, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale dhe se do të jetë më i kujdesshëm për qenin e llojit Pitbull në pronësi të tij, po ashtu gjykata si rrethanë lehtësuese për të pandehurin mori edhe faktin se i njëjti ka luajtur rol relativisht të vogël në kryerjen e veprës penale meqenëse qeni i tij ishte i lidhur mirëpo i njëjti e kishte këputur lidhësen (tojën) dhe më pas e kishte sulmuar të dëmtuarin duke i shkaktuar lëndime trupore ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata mori faktin se i dëmtuari është viktimë e ndjeshme siç përcaktohet në nenin 122 pika 39 e KPRK-ës, po ashtu si rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata mori edhe shkallën e dëmit të shkaktuar me vepër penale meqenëse nga kjo vepër penale tek i dëmtuari është shkaktuar lëndim i lehtë trupor i përshkruara si në ekspertizën mjekoligjore në emrin e tij andaj duke u bazuar në të lartcekurat

dhe në kuptim të nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës gjykata të pandehurit i shqiptoj dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor të paraparë si në nenin 72 të KPRK-ës gjithnjë duke konsideruar se me dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimet si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit ndërsa me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimet me gjobë dhe lartësisë së saj gjykata pati parasysh edhe gjendjen ekonomike të të pandehurit e cila sipas deklaramit të tij është e mesme dhe rrjedhimisht gjykata konsideron se me këtë dënim të njëjtit por as familjarëve të tij nuk u cenohet mirëqenia ekonomike.

5. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata vendosi që i pandehuri i lartcekur të dëmtuarit I. M. për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata duke bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro) si shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.145/2021 me datë 23.06.2021.

Zyrtarja Ligjore,
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermaxhaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.